



## PROCESVERBALI

Nga mbledhja e rregullt e Kuvendit Komunal të Rahovecit, e mbajtur më 31.08.2015 me fillim në ora 10.15. Mbledhjen e kryesoit kryesuesi i Kuvendit Nahit Elshani.

**Kryesuesi Elshani** – Fillimisht më lejoni të përshëndes Kryetarin e komunës z. Idriz Vehapin, nënkyetarin z. Xhemali Haxhimustafa, drejtoret e drejtoreve, delegatët e pranishëm, përfaqësuesit e OSBE-së, monitoruesin e KDI-së, KFOR-it, përfaqësuesit e mediave dhe të gjithë të pranishmit e tjerë. Për këtë mbledhje propozoj këtë:

## Rend Dite

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar,
2. Shqyrtimi i Raportit të auditimit për pasqyrat financiare të komunës së Rahovecit për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2014,
3. Shqyrtimi dhe aprovimi i propozimit për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për ushtrimin e veprimtarisë së transportit taksi të udhëtarëve 01 nr. 811 të datës 28.003.2013,
4. Shqyrtimi dhe aprovimi i propozim Vendimit për hapjen e shqyrtimit publik për draft planin Rregullues të Hollësisë për "Qendrën e vjetër të qytetit" në Rahovec,
5. Vendimi për revidimin e projektit - ndërtimi i kanalit të kullimit të tokave bujqësore në fshatin Celinë,
6. Propozim vendimi për lejimin e bartjes së mjeteve nga një ndarje buxhetore në një ndarje tjetër,
7. Vendimi për pagesën e mëditjeve të komisioneve,
8. Pyetjet dhe përgjigjet në pyetjet e Këshilltarëve.

**Kryesuesi** – Si pikë shtesë të rendit të ditës e keni një kërkësë për revidimin e projektit - Ndërtimi i kanalit të kullimit të tokave bujqësore në fshatin Celinë, ju ka ardhur me material, ndërsa një kërkësë nga OFAKOS ka ardhur gabimisht në material. Po ashtu kemi edhe një kërkësë nga Drejtoria e financave që të shtohet si pikë shtesë propozim Vendimi për lejimin e bartjes së mjeteve nga një ndarje buxhetore në një ndarje tjetër, për këtë ma mirë do na shpjegoj drejtori i financave.

**Lulzim Sylejmani** – Propozim Vendimi për lejimin e bartjes së mjeteve nga një ndarje buxhetore në një ndarje tjetër, me ligje na lejohet që të aprovojmë në kuvend një masë deri në 5 % pastaj ky vendim aprovohet në ministri. Pra kjo është arsy që na ka detyruar që të kthejmë prapë në aprovim në kuvend komunal sepse disa pagesa që jemi duke i bërë nga kapitalët dhe janë në shërbime do ti kalojnë këto mjete në mallra dhe shërbime në shumë prej 74,051.08 €.

**Rasim Fazliu** – Ne si kuvend sot duhet të marrim një vendim për pagesën e komisioneve të cilat e kanë kryer punën, propozoj që kjo të futet si pikë shtesë e rendit të ditës.

**Fatmir Iska** – Plotësisht pajtohem me kolegut Rasim në këtë drejtim, mua më kanë hequr qëllimisht dhe me tendencë nga disa pagesa që ma herët kam qenë si anëtar i komisionit, besoj se kjo nuk është mirë të ndodhë vetëm për shak se jam në opozitë. Kam një kërkësë, është një vajzë nga Rahoveci Samra Bugari që vuan nga sëmundja e leukemisë dhe është mirë që ne si kuvend të marrim një vendim që ti ndihmojmë me një shumë të hollave, kryetari mund të sheh se sa kemi mundësi, kërkoi që kjo të shqyrtohet dhe të merret një vendim.

**Kryesuesi** – Sa i përket propozimit të Rasimit ne e kemi vendimin dhe nuk ka nevojë për vendim tjetër, por do të kërkojmë zbatimin e vendimit i cili është në fuqi.

**Lulzim Sylejmani** – Vendimi ekzistues për pagesën e komisioneve që është 30 € është vendim për pagesën e mëditjeve i cili e mbulon pozicionin e pagave dhe mëditjeve që janë në kuvend. Te pozicioni i pagave dhe mëditjeve në kuvend ato komisione ne nuk kemi mundësi t'i paguajmë sepse mjetet janë të planifikuara në shtator të vitit të kaluar, mjetet ka vetëm për ti paguar KPF, KKSB dhe komitetet tjera. Komisionet që ju jeni duke i kërkuar që ti paguajmë mua më duhet një vendim nga kuvendi që më lejoni që të bëjë pagesën nga mallrat dhe shërbimet.

**Kryesuesi** – Ne mundë ta fusim si pikë të rendit të ditës dhe të marrim një vendim që komisionet që i ka formuar kuvendi të paguhen nga pozicioni mallrat dhe shërbimet.

**Rukije Krasniqi** – Pse janë duke na u lëshuar në konto mëditjet vetëm prej 90 € e jo mëditja e plotë.

**Lulzim Sylejmani** – Për çështjen e pagesës së mëditjeve në shumë komuna është bërë vetëm pagesa e bazës ndërsa pjesa e seancave prej 125 € për shkaqe të sistemit nuk është bërë pagesa kështu na është thënë neve. Ne kemi kërkuar që ata të na zotohen që në muajin që vjen të bëhet pagesa në mënyrë retroaktive, ata janë zotuar që muajin e ardhshëm do të bëhet pagesa në mënyrë retroaktive.

**Munib Durguti** – Kërkësën që e pati z. Fatmiri për ndarje të subvencioneve për Samren, desha ta informoj Fatmirin dhe të gjithë juve se Kryetarit si i ka ardhur kërkesa i ka ndarë 1.000 € pra aq sa i lejohet me rregulloren për subvencione.

**Kryesuesi** - E qesë në aprovim rendin e ditës me këto pika shtesë : Vendimi për revidimin e projektit - ndërtimi i kanalit të kullimit të tokave bujqësore në fshatin Celinë, Propozim vendimi për lejimin e bartjes së mjeteve nga një ndarje buxhetore në një ndarje tjetër dhe propozimin e fundit lejimin e bartjes së mjeteve nga mallrat dhe shërbimet për pagesën e komisioneve të cilat i ka formuar kuvendi. Kush është për aprovimin 'e këtij rendit të ditës: Konstatoj që rendi i ditës është aprovuar në mënyrë unanime.

1. **Aprovimi i Prosesverbalit nga mbledhja e kaluar.** A ka dikush tani ndonjë vërejtje. E qesë në aprovim procesverbalin: Konstatoj që në mënyrë unanime është aprovuar procesverbal.

2. **Shqyrtimi i Raportit të auditimit për pasqyrat financiare të komunës së Rahovecit për vitin e përfunduar deri më 31 dhjetor 2014, fjalën e ka Kryetari Komunës z Idriz Vehapi.**

**Kryetari Vehapi** – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit. Më lejoni që t'ju them si Kryetar Komune dhe si zyrtar kryesor administrativ se këtë raport e marr real me ato vërejtje të auditorit, me gjitha rekondiminet që janë dhënë në raport do të bëjmë përpjekje që ti plotësojmë. Vërejtja në paragrafin 2 ku thuhet se ekzekutimi i buxhetit, hyrja dhe dalja e parasë, për këtë drejtori i financave do të sqaroj se pse ka ndodhë ajo dhe mos ekzistimi i automjeteve si pasuri e komunës, për mua është goxha interesante që nuk janë paraparë edhe unë kam vërejtje në këtë pikë. Ndërsa tek parografi i parë ku thuhet se komuna këtë klasifikim kështu e ka gjetur do të bëjmë përpjekje që ta përmirësojmë aq sa mundemi dhe gjitha komunat kanë probleme me këtë çështje.

**Selim Duraku** – Desha të ndalem tek 14 rekondimet ose çështjet e auditorit të përgjithshëm të cilat janë me prioritet të lartë duke lanë anësh ato me prioritet të mesëm dhe të ulët, të cilët ndikojnë drejtpërdrejt në prioritetin dhe performancën e komunës ndaj ZAP-it dhe vet saj. Çështja e parë është mos regjistrimi i SMFK të gjithë pasurive dhe pronës të komunës që mbizotërojnë në vlerësimin dhe vlerat e pasurisë në pasqyrat vjetore financiare. Çështja e tjetër është procesi i përgatitjes së pasqyrës vjetore financiare prioriteti i lartë, në nenin 13 raporti i ekzekutimit të buxhetit të hyrat e pasurisë të gatshme në shtyllën buxhetore finale, të hyrat e komunës prezantohen më të ulëta për 67,554.00 € kurse vlera e prezantuar është 950,000.00 €, duhet të jetë 1,17,554.00 €. Neni 13 dakja e parasë së gatshme tek shtylla buxhetore e buxhetit final, komuna ka prezantuar shumën 10,839,000.00 €, ndërsa buxheti final është 10,907,411.00 €, kemi mospërputhje afër 68,411.00 €. Çështja e 3 është adresimi i rekondimeve nga viti paraprak, kjo ka rezultuar me pasqyrat vjetore financiare jo të sakta, mos respektimi i plotë i rregullores për ndarjen e subvencioneve, menaxhimi i dobët i pasurive përfitim jo i mjaftueshëm nga audutimi i brendshëm. Çështja e 4 është pagesa sipas vendimeve gjyqësore, tek neni 39.2 i LMFP –së prioriteti i lartë, pagesat e tillë risin rrezikun që projektet e planifikuara të mos realizohen si dhe mund të kenë efekte të aktiviteteve të tjera të komunës. Çështja numër 5 është programi i investimeve publike, komuna nuk përmban dhe nuk azhuron programin e investimeve publike në 12 raste, pra kjo e ritë rrezikun që të bëhen shkurtimet e detyrueshme të projekteve të tjera të aprovuara nga kuvendi. Çështja numër 6, mos inkasimi i qirave për pronat komunale edhe kjo është prioritet i lartë. Çështja numër 7 ka të bëjë me dobësitë e sistemit të prokurimit, pra edhe kjo është prioritet i lartë. Në vitin 2014 komuna kishte hyrë në obligime kontraktuale më shumë se mjetet e ndara me ligjin për ndarje buxhetore. Ni i identifikuam 3 raste, 1 asfaltimi i rrugës Pastasel – Kaznik, ndërtimi i shkollës filllore në Opterushë dhe ndërtimi i ndërtuesës së përbashkët të banimit për familje në nevojë. Shuma e ndarjes buxhetore për rastet e cekura ma lartë për 3 vite ishte 475,400.00 € ndërsa vlera kontraktuale për 3 projekte është 1,265,863.00 €. Deficiti i fondeve në raporte me kontratat e lidhura ishte 790,463.00 €, në të tri rastet komuna nuk i ka informuar operatorët ekonomik me shkrim. Në 19 raste të tjera komuna ka bërë keq klasifikim të shpenzimeve me vlerë totale prej 191,613.00 €. Prioritet tjetër i lartë është dobësitë jo sistematike në prokurim. Çështja tjetër e lartë kemi ndryshimin e pozicioneve të kontratës në procesin e ekzekutimit të punimeve në fshatin Celinë. Sipas kontratës kanali është dashur të jetë i hapur ndërsa me ndryshimin e kontratës do të bëhet i myllur. Çështja me numër 11 është pagesa sipas marrëveshjes së bashkëpunimit, pra edhe kjo është një prioritet i lartë. Komuna me 25.04.2015 kishte lidh memorandum bashkëpunimi me bashkëfinancim me CARITAS Kosova në vlerë prej 70,000.00 €. Komuna ka participuar me 55,000.00 € ndërsa CARITAS nuk ka participuar në këtë projekt, por ka pas ta dhurojë një veturë për 8 persona por edhe atë nuk e ka bërë ende. Çështja e fundit është mangësia e zbatimit të rregullores për subvencione, pra edhe kjo është një prioritet i lartë. Mos regjistrimi dhe mos inventarizimi i pasurive po ashtu prioritet i lartë. Trajtimi i llogarive të arkëtuara prioritet i lartë që duhet të përmirësohet dhe auditimi i brendshëm edhe kjo është prioritet i lartë, plani vjetor i auditimit të brendshëm ishte bërë me mungesë të një analize të vlerësimit të rrezikut, ku vetëm një numër i rekondimeve i dhënë nga auditori i brendshëm ishin adresuar.

**Afrim Limani** – Raportin e auditorit të vitit 2014 e cilësoj kështu: një proces i nisur mirë dhe mbarë dhe në fund i stagnuar, pse e them kështu. Vënia e titullit Raport të kualifikuar e ka epitetin e një rapporti të keq. Këtë epitet e ka marr në saje të 2 gabimeve amatoreske, njëri në kuadër të Drejtorisë së Financave dhe tjetri në kuadër të Drejtorisë së Ekonomisë. Pra mos deklarimi i saktë i të hyrave dhe daljeve të parave në pasqyrat financiare dhe nën vlerësimi i pasurive fikse. Në momentin kur ne e kemi marr qeverisjen pasqyrat financiare sidomos të pasurive fikse kanë qenë zero. Ne e kemi trajnuar punëtorin, e kemi formuar komisionin dhe e kemi bërë një pjesë të regjistrimit të aseteve dhe gradualisht për çdo vite kemi pas përmirësimë në pasqyrat financiare. Në bazë të rekondimeve të auditorit

përmirësimet e rekomandimeve të vitit të kaluar ku janë adresuar 6 pjesërisht kurse 5 jo. Jo vetëm që nuk janë përmirësuar këto, por janë krijuar edhe të tjera të cilat shumë lehtë kanë mundur të eliminohen. E kujtoj që tash një vit drejtori është zotuar para deputetëve dhe në bazë të atij zotimi që e ka bërë ai i kemi besuar të gjithë, zotimin e ka bërë që pasqyrat financiare për vitin 2014 dhe tutje do të janë shumë të mira. Por edhe unë i kisha besuar drejtorit sikurse të mos kisha kaluar nëpër këto procese që është duke i kaluar ai, e kam ditë se ky proces nuk mundet të realizohet vetëm kurrsesi pa unitet të përgjithshëm e të gjithë drejtorëve e pastaj mund të dalin pasqyrat financiare perfektë. Kjo ishte sa i përket formës së pasqyrave financiare sepse pasqyrat financiare kanë formën dhe përbajtjen e vet. Në përbajtje për mendimin tim ky raport nuk është aspak objektiv, nëse e bëjmë një krahasim me pasqyrat financiare të vitit të kaluar. Ekzaminimi i mostrave në këtë vit është bërë shumë pak në krahasim me vitin e kaluar. Mua më çudit fakti se pse nuk është ekzaminuar asnjë mostër në kuadër të kontratave mbi vepër sepse është një numër goxha i madhe i këtyre kontratave. Jam duke u ndier shumë i relaksuar sepse vazhdimisht drejtori i Shërbimeve dhe ai i Financave na kanë dhanë vërejtje se pse ne në mandatin tonë kemi lidhë kontrata me vlera të mëdha kurse mbulesë të vogël të buxhetit, por deklarimi ynë ka qenë se brenda 3 viteve do të bëhet pagesa e kontratës që është shumë e logjikshme gjë që edhe këta tash e kanë vërtetuar që është ashtu. Mendoj se secili deputet si i opozitës ashtu edhe i pozitës dëshiron që pasqyrat financiare për komunën tonë të dalin mirë. Në fund i kisha rekomanduar drejtorët e ekzekutivit që problem e kanë vetëm regjistrimin e pasurive fikse, që të trajnoni një punëtor dhe të formoni një komision me njerëz të vullnetit dhe përkushtimit të mirë e pastaj pasqyrat financiare do të dalin mirë për komunën e Rahovecit. Problemet tjera që i ka gjetur auditori janë probleme të vogla të cilat me një përkushtim dhe një vullnet të drejtorëve shumë lehtë munden të eliminohen.

**Rasim Fazliu** – Sipas të gjeturave dhe parregullsive të auditorit të përgjithshëm, është mirë që në të ardhmen të përmirësohen dhe mos të përsëriten çdo vit parregullsi të njëjtë. Të hyrat dhe të dalurat e parasë së gatshme janë nënvlerësuar për 67,554.00 €, pastaj donacionet që janë prezantuar 30,000.00 €, auditori ka than se duhet të janë 15,844.00 €. Është për tu çuditur se si 28 automjete komunale nuk janë të përfshira në pasurin fikse të komunës. Buxheti final për vitin 2014 në aspektin e ekzekutimit ka paraqitur një performancë të mirë sepse 95 % e buxhetit është ekzekutuar. Në vitin 2014 thesari ka ekzekutuar pagesa në vlerë prej 36,008.00 € dhe 323,550.00 € për pagesën e obligimeve për vitet e kaluara, kjo e ritë rrezikun e mos realizimit të projekteve të planifikuar. Tek zyra e prokurimit thuhet se shuma e ndarë për 3 projekte është 475,400.00 €, ndërsa vlera e kontratave të lidhura është 1,265,863.00 €, deficiti i fondeve në raporte me kontratat është 790,463.00 €. Ne gjithmonë kemi thënë që të lidhen kontratat me aq mjete sa i kemi të zotuara. Auditori i përgjithshëm thotë se operatorët ekonomik të cilat janë eliminuar nga tenderi ose nga diçka tjetër duhet të lajmërohen se deri më tanë nuk janë lajmëruar, pra edhe kjo duhet të përmirësohet. Në 11 raste thuhet se është bërë keq klasifikimi i shpenzimeve në vlerën prej 191,613.00 €, pagesat janë regjistruar në kategorinë e pagesave kapitale ndërsa natyra e shpenzimeve është bërë në kategorinë e subvencioneve dhe mallra dhe shërbime. Në faqe 20 thuhet se është bërë sigurimi i 12 automjeteve komunale ndërsa pagesa është kryer pa procedurën e prokurimit. Është mirë që këto gabime të eliminohen dhe të mos përsëriten. Rreth kanalit të kullimit të tokave të kanalit të fshatit Celinë, komuna me datën 02.09.2013 ka lidhur kontratë për ndërtimin e kanalit për kullimin e tokave bujqësore në fshatin Celinë në vlerë prej 437,858.00 €. Ky projekt sipas kontratës parashihet të përfundoj brenda 3 viteve, auditori i përgjithshëm ka identifikuar se gjatë ekzekutimit të kontratës janë bërë ndryshime substanciale të pozicioneve të kontratës pa aprovim paraprak me shkrim të menaxhmentit të komunës, pra vetëm me pëlqimin e organit mbikëqyrës. Sipas kontratës kanali është dashur të jetë i hapur i ndërtuar me beton, ndërsa tash është duke u ndërtuar i myllur me gypa betoni nëpër vende të caktuara. Pagesa e bërë deri më tanë për këtë projekt është 80,000.00 €. Do flas pak edhe për auditorin e brendshëm që e kemi në komunë, komiteti i audutimit të brendshëm duhet të funksionoj, për vitin 2014 nuk janë takuar asnjëherë, sepse auditimi i brendshëm ja hapë sytë qeverisë komunale dhe ju tregon se ku nuk janë punët mirë.

**Fatmir Iska** – Tek rreziqet domethënëse në pasqyrat vjetore financiare faqe 11 mos regjistrimi në SMFK të gjitha pasurive në pronësi komunale, mendoj se kjo është vetëm aspekt teknik ku mungon vullneti dhe angazhimi i një komisioni që të formohet dhe ta kryej këtë punë. Tek faqe 12 pajtueshmëria me pasqyrat vjetore dhe kërkuesat tjera për raportim, po ashtu edhe këtu kemi të bëjmë me aspektin teknik, ku në raportin financiar janë prezantuar të hyrat vjetore 1,17,554.00 € ndërsa ka qenë e paraparë 950,000.00 € E gjitha kjo lidhet me aspektin teknik dhe ka rekomandime që në të ardhmen të përmirësohet. Në faqe 13 kemi rekomandime të vitit paraprak, mendoj se këtu është duke u krijuar një shprehi që nga pas lufta jo vetëm në komunën tonë, por në shumë komuna të Kosovës është duke u përcjellë kjo shprehi e mos adresimit të rekomandimeve nga ana e komunave. Në faqe 16 kemi pagesat sipas vendimeve gjyqësore, duke e cekur vetëm në thesar ku drejtpërdrejt janë ekzekutuar pagesat dhe sipas meje kjo është në rregull, sepse nëse ti nuk merr ajo që të takon aty ku duhet atëherë ekziston linja tjetër që është thesari. Tek faqja numër 17 kemi programin e investimeve publike, ku thuhet se komuna nuk e mirëmban dhe azhurnon programin e investimeve publike dhe i cek se sa raste janë aty, pra kemi një menaxhim të dobët të këtij programi. Tek të hyrat në faqe 17 që lidhet me faqen 18 ku kemi mos inkasimin e qirave të pronave komunale kjo ndërlidhet edhe me vitet paraprake, ne e dimë se janë lidhur kontratat dhe është shpallur ankandi dhe kjo është mirë, por prapë duhet të kemi

një kontroll të shtuar mbi këtë qiramarrës. Po ashtu kemi të hyrat e dobëta nga tatimi në pronë, dhe këtu është dashur të futen edhe të hyrat e drejtorisë së urbanizmit dhe drejtorisë së shërbimeve publike, pra kemi një mospërputhje në planifikim. Në faqen 19 është zyra e prokurimit ku janë cekur 3 projekte që nuk janë paguar, por ka edhe kontrata të tjera që në vitin 2014 dhe në vitin 2015 janë lidhur për 2 ose 3 vite dhe kemi mjete të paraparë që hynë në obligime kontraktuale. Po ashtu mungon njoftimi i operatorëve ekonomik që janë të pa suksesshëm në tenderim, në rekomandim është cekur që është mirë kjo të respektohet dhe të njostohen operatorët ekonomik që nuk janë përfitues. Kemi ndryshim të pozicioneve të kontratës në procesin e ekzekutimit të punimeve prioriteti i lartë, kanali i kullimit të tokave në fshatin Celinë. Punë kryesi nuk e di se deri ku ka shkuar me punimet por ka bërë ndërrim të pozicioneve, pune kryesi në këtë rast ndërron pozicionet pa kurrfarë konsultimi ose pëlgimi të organit mbikëqyrës dhe besoj se nuk kemi çka të diskutojmë rreth kësaj pike. Pagesat në bazë të marrëveshjeve të bashkëpunimit prioritet i lartë faqe 21 ku kemi memorandum bashkëpunimi me CARITAS Kosova, vlera e projektit ka qenë 70,000.00 € komuna ka përticipuar me 55,000.00 € ndërsa CARITAS Kosova është dashur të siguroj një veturë me 8 ulëse dhe kjo nuk është siguruar nga ana e tyre, mendoj se këtu Kryetari duhet të jetë me azhur në mënyrë që ky projekt të ekzekutohet. Pastaj prapë është cekur edhe një projekt për sallën e dializës dhe për procesin e dezinfektimit, ku komuna këtu hynë me participim me 16,000.00 € ndërsa CARITAS Kosova me 3,218.00 €. Tek subvencionet dhe transferet faqe 23 kemi mangësi në zbatimin e rregullores për subvencione, ceket këtu klub i futbollit KF Rahoveci 11,300.00 € i cili është subvencionuar pa plotësuar kriteret e përcaktuara në rregulloren e brendshme komunale, po ashtu festivali "Anadria Jehon" po ashtu edhe këtu nuk janë zbatuar kriteret e rregullores. Mos regjistrimi dhe mos inventarizimi i pasurive komunale ku kemi prioritet të lartë, por besoj se kjo është vetëm një gabim i aspektit teknik për tu përmirësuar. Faqe 25 trajtimin e arkëtit, borxhet ishin diku rreth 146,000.00 € ndërsa sipas regjistrit komunal 139,000.00 € pra kemi një pasqyrim jo të saktë në këto pasqyra.

**Azbi Gashi – Si i arsyeton drejtori të gjitha këto të gjeturat e auditorit.**

**Rukije Krasniqi –** Sa i përket auditimit gjeneral është tmerrësish keq. Unë u habita ku tha Afrimi se është mirë, nuk po mundem të imagjinoj se si është ma keq se kjo. Faqe 17 çështja 5 tek rreziku thuhet : komuna ka menaxhim të dobët të këtij programi, mua më vije çudi se si drejtorët të vetëquajt shkencëtarë, se si nuk e kanë planifikuar menaxhimin kur vetën e kanë konsideruar ekspertë, është një fjalë ku thuhet se kur mungon planifikimi i menaxhimit, ke planifikuar dështimin. Faqe 20 çështja 10, ndryshimi i pozicionit të kontratës në procesin e ekzekutimit të punimeve, prioriteti i lartë. Në fshatin Ratkoc kur ka qenë planifikimi fillestar vetëm ka pas të shtrohen kubëzat, komunës i ka kushtuar edhe më shtrunjë me planifikim të ri. Te rruga në fshatin Ratkoc kanë qenë vetëm motivet politike dhe hakmarrje kundër bizneseve të cilët nuk i përkasin një partie politike kryesisht PDK-së. Po ashtu të gjeturat tjera janë edhe shkelje të rregulloreve dhe marrëveshjeve të ndryshme. Kemi shkelje të marrëveshjes me CARITAS Kosovën, në vend se të investoj 70 % CARITAS Kosova ka investuar komuna, deri më tanë komuna është ankuar për mungesë buxheti, por na del e kundërtë komuna i del në ndihmë CARITASIT me 70 % ndërsa CARITAS as 30 % nuk ka qenë në gjendje. Po ashtu edhe këtu është bërë punësimi i militantëve të partisë. Kemi shkelje të rregullores për subvencione, ku zyra e Kryetarit ka marr vendim që të subvencionoj me 3500 €, ndërsa duhet mbi 2.000 € subvencione të merret vendim nga kuvendi. Auditimi i brendshëm të ka kursyer Kryetar sepse i ke pas njerëzit e tu aty, por thuhet me një fjalë se me ja thye qafën njërit një herë duhet me e përkëdhel, pra nuk është mirë sepse të gjitha këto të këqija sapo janë evidentuar këtu sot nuk kishin me ndodhë. Kjo që është bërë është bërë vetëm në vija të trasha sepse auditimi nuk është bërë në arsim, të gjithë e dimë se çka po ndodhë në arsim, nuk është bërë auditimi në tenderime aty që ndodhin keqpërdorime më të mëdha.

**Bahtjar Hoti –** Edhe në formën elektronike dhe fizike secili kuvendar e ka pas raportin e auditorit, shumë mirë janë të shënuar gjetjet, shkalla e rrezikut dhe rekomandimet. I sugjeroj secilit kuvendar të jetë i vëmendshëm dhe rekomandimet të shikohen se a po respektohen nga Kryetari dhe stafi i tij dhe jo të bëjmë debate politike pa nevojë.

**Lulzim Sylejmani -** Faleminderit për sugjerimet dhe pyetjet nga ana e juaj. Me përgjegjësi të plotë e them se ky raport është i drejtë dhe pasqyron realitetin e gjendjes e cila ka qenë. Por duhet të keni parasysh si ish drejtori i financave po edhe kolegët e tjerë, se ne kemi punuar me buxhetin e vitit 2013 dhe shumë të gjetura që i kanë gjetur këtu janë pasojë e mos aprovimit të buxhetit. E ndicj vetën fajtor vetëm tek neni 13 i pasqyrave financiare sepse koha e korrigimeve është 30 marsi ndërsa ne i kemi dërguar me datën 19 mars, ndërsa në sistem tejkalimi i të hyrave vetanake dhe donacionet tek atëherë kanë azhuruar në sistemin SMFK, pra kjo krejt është pasojë që nuk i kemi përcjellë deri me datën 30 mars ndryshimet që kanë ndodhë në sistem. Sa i përket keq klasifikimit të asaj shume që ju jeni duke e parë unë e them se ky buxhet ka qenë i planifikuar ashtu ne vetëm e kemi shpenzuar. Sa i përket asaj se ka mare peshë që ky raporte keq kualifikohet është regjistrimi i asetëve dhe pasurisë komunale, nuk e amnistoj vetëm dhe të them se shumica e komunave e kanë keq regjistrimin e pasurisë, por ne kemi bërë një përmirësim tek regjistrimi i pasurive të vlerave që i kemi gjetur të mbivlerësuara, por e dimë që ka edhe shumë punë për tu kryer tek regjistrimi i asetëve. Të gjitha rekomandimet e tjera që ju i lexuat ne e kemi bërë planin e menaxhimit dhe besoj se në fund të vitit në rapport të auditorit këto rekomandime do të janë të përmirësuara, që janë përsëritur me vite. Për pjesë të tjera që i takojnë drejtorive të tjera nuk isha ndalë sepse nuk është punë e imja e drejtpërdrejtë.

### 3. Shqyrtimi dhe aprovimi i propozimit për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për ushtrimin veprimtarisë së transportit taksi të udhëtarëve 01 nr.811 të datës 28.003.2013.

**Fehim Fetoshi** – Komuna ka një rregullore komunale për shërbime publike, figuron që lejet për auto taksi nuk mund të marrin personat që janë me moshë mbi 65 vjet. Ne kemi pas kërkesë nga një qytetar i cili me këmbëngulje ka kërkuar që të ketë të drejtë e veprimtarisë së tij edhe pas moshës 65 vjet sepse një e drejtë e tillë i garantohet me ligj. Në komuna tjera mund të marrin leje për veprimtarin e taksistit edhe persona mbi 65 vjet, por me kushte që çdo vit të merr certifikatën shëndetësore.

**Rasim Fazliu** - Si ka qenë deri më tanë e rregulluar për marrjen e lejes për veprimtarin e auto taksi.

**Ejup Kabashi** – A është në kuadër të ligjit sepse kjo shkon mendoj në kuadër të ministrisë e cila i pajis me dokumentacion. A kemi ne të drejtë të aprovojmë një rregullore të tillë, mos ndoshta do të jemi në kundërshtim me rregulloret e komunikacionit dhe ligjeve.

**Besnik Hoti** – A ceket se prej cilës moshë mundet të filloj personi të punoj veprimtarin e auto taksi, a mundet të filloj pas moshës 18 vjeçare.

**Erlira Mullabazi** – Këtu në këtë propozim vendim thuhet se certifikata e mjekut nuk duhet të jetë më e vjetër se një vjet, propozoj të bëhet këtu një ndryshim dhe të bëhet çdo 6 muaj sepse pensionistet paraqiten çdo 6 muaj pranë Qendrës për punë sociale për të vërtetuar që janë gjallë, pra propozoj që të nxjerrin edhe certifikatën nga mjeku çdo 6 muaj sepse moshë 65 vjeçare është delikate dhe koha prej 1 viti është shumë e gjatë sepse mund të ndryshoj gjendja shëndetësore e njeriut.

**Fehim Fetoshi** - Rasim deri më tanë ka qenë deri në moshën 65 vjeçë kanë pas të drejtë të ushtrojnë veprimtarin e taksistit. Sa i përket pyetjes që e bëri z Ejupi, ne së bashku me drejtorin e inspektoratit e kemi laburuar bukur mirë ligjin dhe nuk kemi gjetej diç decidive për këtë çështje, ligji ja ka lënë që kjo të vendoset me rregullore, pra nuk ka të bëjë asgjë në kundërshtim me ligjin. Mendoj është ma praktike që të shkohet çdo 1 vjet se sa çdo 6 muaj, sepse do të jetë një ngarkesë për ata dhe kushton. Propozimi ynë është të jetë 1 vjet dhe besoj se është reale.

**Kryesuesi** – E qesë në aprovim propozim vendimin për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për auto taksi: Konstatoj se me 4 abstenime dhe asnjë kundër është aprovuar pika 3 e rendit të ditës.

### 4. Shqyrtimi dhe aprovimi i propozim Vendimit për hapjen e shqyrtimit publik për draft planin Rregullues të hollësishëm për “Qendrën e vjetër të qytetit” në Rahovec.

**Fehmi Hoxha** – Në fillim është mare Vendimi për hartimin e planit rregullues të hollësishëm të zonës qendra e vjetër e qytetit. Në bazë të ligjit për planifikim hapësinorë i kemi zhvilluar deri më tanë 4 debate, 6 debate publike dhe punëtori me qytetarë, draft plani është i gatshëm. Në bazë të Ligjit për planifikim hapësinorë dhe në bazë të Ligjit për vetëqeverisje lokale parashihet që të merret një Vendim për shqyrtim publik të planit rregullues të hollësishëm të qytetit “Qendra e Vjetër e Qytetit”. Këtu ka të bëjë me 27.4 hektar dhe për herë të parë komuna e Rahovecit do e ketë një zonë të rregulluar në bazë të Ligjit për planifikim hapësinorë me plan rregullues të hollësishëm. Tani duhet të merret vendimi ku pastaj 1 muaj do të jetë në shqyrtim publik. Do të ekspozohen në qendrën e kulturës “Mensur Zyberaj” në galerinë e artëve dhje qytetarët e interesuar do i shohin skicat dhe po ashtu do jetë një person vazhdimit aty që do i merr të gjitha propozimet dhe rekomandimet e qytetarëve brenda 1 muaji. Draft plani përmban 74 faqe. Këtu janë prezent përfaqësuesit e CHVB –së të cilët i falënderoj për punën e bërë si partnerë të këtij projekti. Shkurtimisht në pikat e shkurta në mënyrë profesionale zyrtarët e CHVB do ju prezantojnë projektin.

**Visar Haxhibeqiri** – Përfaqësues i CHVB –së ka prezantuar në pikë të shkurta me anë të sllajdeve Projektin “Qendra vjetër e qytetit të Rahovecit”. Në shqyrtimin publikë ky projekte do të prezantohet më gjërësisht dhe më detaisht.

**Kryesuesi** - E falënderoj z Visarin për prezantimin e bërë. E qes në votim këtë pikë të rendit të ditës: Konstatoj se në mënyrë unanim është aprovuar Vendimi për marrjen e Vendimit për hapjen e shqyrtimit publik për planin rregullues të hollësishëm “Qendrën e vjetër të qytetit” në Rahovec.

### 5. Vendimi për revidimin e projektit - ndërtimi i kanalit të kullimit të tokave bujqësore në fshatin Celinë.

**Lulzim Hasku** – Ky projekt ka filluar në vitin 2013, projektin ka gjithsej 7 krahë me gjatësi 7 m dhe 123m dhe përfshinë diku rreth 148 hektarë. Vlera e kontratës është 437,858.95 €, punimet është duke i kryer kompania Prioint Prishtina. Një pjesë e punimeve është kryer në vitin 2013, pjesa më e madhe është kryer në vitin 2014, me vlerë diku afér 80,000.00 €, pra 15 % e vlerës totale të projektit është kryer. Me rekomandim të kompanisë mbikëqyrëse dhe të kryetarit të komunës kërkohet që të bëhet revidimi i këtij projekti nga një kompani e specializuar në mënyrë që ky projekt të jetë funksional dhe në të mirë të komunitetit. Këto janë faktorë kryesor që kanë ndikuar që ne të fortë nga ana e kompanisë mbikëqyrëse ne si drejtori e kemi pranuar këtë ndryshim. Si problem tjetër po ashtu ka fortë nga ana e kompanisë mbikëqyrëse ne si drejtori e kemi pranuar këtë ndryshim. Si problem tjetër po ashtu ka dalë të jetë edhe kontrollimi i rrënjos respektivisht rrjedhës së ujut, sepse në disa pjesë rënia është shumë e vogël dhe

me këtë revidim edhe një herë do të shikohet se sa është rënia e ujit. Problem tjetër është se në një prej krahëve me gjatësi prej 850 m dhe sidomos në një pjesë prej 250 m shtrihet paralel me hekurudhën dhe pas verifikimit që e kemi bërë na ka dalë se kjo nuk është tokë e komunës dhe as e ndonjë qytetari por është pronë e hekurudhës së Kosovës. Ne mendojmë se një kompani profesionale duhet ta bëjë revidimin dhe të na i zgjidhë të gjitha këto probleme që na janë shfaqur.

**Selim Duraku** – Duke mare parasysh ndryshime substanciale që janë bërë nga kompania dhe që janë aprovuar nga organi mbikëqyrës, me të vërtet ato toka kanë nevojë të rregullohen dhe të merret ky revidim për të mirën e atyre qytetareve që kanë tokë në atë pjesë sepse me vite të tëra po kanë probleme. Unë do jem pro këtij vendimi.

**Rasim Fazliu** – Dua ta pyes së pari përfaqësuesin e kompanisë mbikëqyrëse z Fatmirin se a ka ai ndonjë detaj ma të saktë se çfarë ndryshime do të bëhen.

**Fatmir Iska** – Dua të lidhem me raportin e auditorit pikërisht për këtë projekt ku thuhet kështu: komuna me datën 02.09.2013 ka lidhur kontratë për ndërtimin e kanalit për kullimin e tokave në fshatin Celinë, në vlerë prej 437,858.95 €, sipas kontratës projekti duhet të përfundoj brenda 3 vitesh. Auditori thotë se janë gjetur ndryshime substanciale të pozicioneve të kontratës gjatë ekzekutimit pa aprovim paraprak të menaxhmentit të komunës, por vetëm me pëlqimin e mbikëqyrësit. Shtrohet pyetja se kush është organi mbikëqyrës që të ndërrojë pozicione pa marr lejen paraprake nga menaxhmenti. Sipas kontratës kanali duhet me qenë i ndërtuar nga betoni, por është ndryshuar dhe është bërë kanali i mbyllur me gypa betoni. Pagesa deri më tanë për këtë projekt është bërë 80,000.00 €, këtu ceket se për shkak të ndryshimeve të mëdha ne nuk kemi qenë në gjendje të sigurojmë se nëse punimet që janë kryer deri më tanë në projekt a janë ekuivalente me kundërvlerën e parasë së shpenzuar. Prandaj, ky ndryshim ka shkaktuar edhe ndryshimin e projektit dhe kjo na qetë në një pozitë që të dyshojmë se ka pasur keqpërdorime. Përpiluesi i projektit që në fillim është dashur të parashë e jo të kemi këtë gjendje që e kemi sot, a do të bllokohen rrugët apo ato parcelat e banorëve është dashur me parapa para se të fillojnë punimet. 80,000.00 € deri më tanë janë paguar prej 437 mijë euro, pra vetëm 15 % e projektit është përfunduar mendoj se është shumë pak sepse kontrata është lidhur me 2013 dhe tanë jemi në përfundim të vitit 2015. Unë dyshoj shumë se ky projekt do të përfundoj në 2016 nëse i marrim për bazë këto ndryshime substanciale. Vota ime do jetë kundër pikërisht për ato arsyet që i përmenda.

**Sinan Jupa** – Një pyetje për drejtorin ose përfaqësuesin e kompanisë mbikëqyrëse. Revidimi i këtij projekti a do të thotë edhe rritje të kostos së tij dhe në çfarë masa. Drejtori ishte shumë i bindur se revidimi është i nevojshëm, nëse ata këmbëngulin në revidim të projektit në mënyrë që ai të jetë praktik dhe të funksionoj kur të kryhet, atëherë duhet të dihet se në çfarë përqindje do të ritet investimi i projektit.

**Afrim Limani** – Pse nuk është bërë në fillim të vitit 2014 revidimi i projektit e jo tash në këtë fazë. Dyshoj se kërkesa e revidimit të projektit mos ka dalë si rezultat i auditimit të pasqyrave financiare për 2014 sepse ka të gjetura edhe në kuadër të këtij projekti.

**Azbi Gashi** – Si është e mundur që të bëhet një projekt ndërsa kur shkojmë për ta implementuar projektin në vend del që është i pazbatueshëm. Ne do të jemi kundër këtij vendimi.

**Lulzim Hasku** – Ky projekt është bërë më 2013, nuk e di a e ka bërë në zyrë pa dal fare në teren. Ky projekt ka filluar me 13,600.00 € në dispozicion në 2013, vitin e kaluar për këtë projekt kanë qenë të dedikuar afér 40,000.00 € por ne kemi arritur që deri më sot investime të kryejmë deri në 80,000.00 €. Sa i përket pyetjes së Sinanit a do të ketë implikime financiare, nëse bëhet revidimi implikime financiare nuk do të ketë. Në 2015 në këtë projekt nuk është punuar fare pra vetëm në 2013 dhe 2014.

**Fatmir Kryeziu** – Përfaqësues i kompanisë mbikëqyrëse. Rasimi pyeti se si do të funksionoj kjo, kemi propozimin me sistem të mbyllur për shkak se 3 m kemi gjërsi të komasacionit, kanali sipas projektit është 1 m i gjër, nëse mundeni ju të funksiononi me 2 m rrugë atëherë në rregull le të vazhdojnë me sistem të hapur. Punimet do të punohen me puseta kulluese pastaj dhe kanal të mbyllur e pastaj del në degëzimin kryesor që e qon direkt tek lumi Drini. Çdo pikë kulluese do ta ketë pusetën.

**Rasim Fazliu** – Konsideroj se kanali i mbyllur 10 m me e pas diametrin do të mbylljet një ditë sepse do të mbushet me dhe, për shkak se të gjitha ujërat nga shpejti do të vinë poshtë. Besoj se me kanalin e mbyllu është si ti hedhësh parat në baltë, mendoj se kjo nuk është zgjedhje.

**Kryesuesi** – Rasimi e pati një zgjidhje që e prezantoj tek zyra e kryetarit, është mirë që t'na prezantoj edhe këtu para kuvendarëve.

**Fatmir Kryeziu** – Ne për këtë arsyet jemi duke kërkuar edhe revidim të projektit, mangësitë e projektuesit i vëren dhe i përmirëson reviduesi dhe jep propozimin se si punohet. Nëse punohet me puseta kontrolluese dhe shkarkuese kemi mundësi të pastrimit të saj. Ende nuk është përfundimtare se do të ndërtohet me kanal të mbyllur, këtë do shohim kur të bëhet revidimi i projektit. Drejtori i ceku 3 arsyet që ne i kemi cekur në teren. Implikime financiare nuk do të ketë sepse janë bërë barazimet me metër gjatësi, pra nuk mundet të kaloj kontratën, ka mundësi që të jetë më lirë e jo më shtrunjëtë. Pusetat do të punohen me standarde, me rrjeta dhe nuk do të lejojnë që gurët të depërtojnë brenda, por duhet edhe banorët pak të mirëmbajnë.

**Rasim Fazliu** – Meqë jam banor i fshatit Celinë, për punët që janë kryer deri më tani jam tejet i shqetësuar dhe punimet më të këqija deri më tani kur në jetën time nuk kam parë. Flasë në emër të banorëve të fshatit Celinë. Të gjithë banorët janë tepër të shqetësuar. Ky është problem i kamotshëm që ekziston ne Celinë. Kur ka filluar ky projekt gjysmëtonësh me të vërtet jemi gëzuar shumë, por siç e thash deri më tani jemi të zhgënjer. Kam një pyetje për organin mbikëqyrës ku ka qenë ai, pse ai nuk ka dalë në vend punime, pse nuk ka konstatuar më herët para se të bëhen gjithë këto investime dhe ti ndërpresë punimet, por ka pritë që të jep vërejtje auditori i jashtëm që aty ka parregullsi të mëdha dhe ndërrime të pozicioneve. Por ne nuk duhet të ndalemi në gabimet e bëra deri më tani por duhet të vazhdojmë më tutje. Është mirë që të bëhet revidimi por unë nuk pajtohem me z Fatmirin që tha se do të mbyllët rruga, banorëve të asaj ana nuk i intereson fare kjo, por atyre i intereson që të shtrohet kanali dhe ti bartë ujërat tek proçka e pastaj të derdhet në lumin Drini. Kam edhe një propozim që kanali ekzistues që është aty që ka qenë funksional më përpara, në atë kanal kanë ardhur ujërat nga Ura e shenjtë dhe i kanë ujitur tokat banorët e fshatit Celinë, por pas ardhjes së Radoniqit dhe sistemit të ujitjes ai kanal e ka ndalur funksionin për ujitjen e tokave, por ka marr një funksion tjetër. Të gjitha ujërat e Celinës, Fortesës dhe Rahovecit janë zbrazur në atë kanal dhe prej aty në proçkë dhe pastaj është derdhur në lumin Drini. Tokat tona të gjitha janë të drenazhuar por ato nuk po munden ti përballojnë ujërat që janë duke ardhur prej shpateve që i ceka më herët. Ne si grupe i PDK do ta përkrahim që të bëhet revidimi dhe plani ashtu si duhet dhe të jetë funksional, por propozoj që përfaqësuesit e komitetit të marrin pjesë në zbatimin dhe revidimin e këtij projekti dhe mbasse hartimit të këtij plani propozoj që prapë ky projekt të vije në kuvend dhe të na tregohet në mënyrë detaile se çka ka ndryshuar projektin.

**Kryesuesi** - Me propozimin shtesë që e bëri z Rasim Fazliu e qesë në aprovim pikën e rendit të ditës: Konstatoj se me 2 vota kundër, 3 abstenime dhe të tjerët pro, aprovohet Vendimi për revidimin e projektit kullimi i tokave bujqësore në fshatin Celinë.

#### 6. Propozim Vendimi për lejimin e bartjes së mjeteve nga një ndarje buxhetore në një ndarje tjetër.

**Lulzim Sylejmani** – Këto bartje edhe në rishikim të buxhetit i kemi kërkuar, por pas kalimit nga ana e Ministrisë dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës, Kuvendi i Republikës së Kosovës nuk ka bërë lëvizje tjera përvèç në kapitale. Arsyen është se raporti i auditorit në keq klasifikim pra pagesa e mirëmbajtjes dhe e CARITASIT që ka zënë vende në atë, keq klasifikim është pikërisht kjo bartje, këto mjete do të kalojnë tek mallrat dhe shërbimet e pastaj do të përdoren për pagesën e këtyre shpenzimeve.

**Fatmir Iska** – Në këto projekte që bëhet bartja nga shëndetësia në mirëqenie sociale dhe në shërbime publike, dua ta di se a kemi drejtë ne që nga investimet kapitale të bëjmë bartje në mallra dhe shërbime, duke e marr për bazë se në raportin e auditorit kemi një rekandim që janë bërë disa shkelje.

**Afrim Limani** – Sa kam njoftuar unë ne në këtë fazë nuk kemi të drejtë të bëjmë bartjen e mjeteve, bartja e mjeteve lejohet vetëm në procesin e rishikimit të buxhetit dhe në procesin e ridestinimit. Po ashtu mendoj se nuk ke të drejtë të bësh bartjen nga kategoria e investimeve kapitale në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve. Pikërisht auditori gjetjet që i ka gjetur është se investimet kapitale janë mbivlerësuar me një vlerë të caktuar të cilat janë bartur nga investimet kapitale në mallra dhe shërbime. Drejtore të kisha propozuar që në procesin e ridestinimit të mjeteve të kryhet ky proces sepse tash sipas mendimit tim nuk ke të drejtë. Vota ime do jetë kundër këtij propozim vendimi.

**Lulzim Sylejmani** – Sa i përket bartjeve të mjeteve auditori nuk ka bërë vërejtje që ne kemi bartë mjete, por ato mjete kanë qenë të planifikuar në kapitale dhe ne kemi bërë pagesa në mallra dhe shërbime. Këtë propozim vendim që sot e kam sjellë këtu në kuvend jam bazuar në Ligjin për financa publike, neni 30 ju lexoj paragrafin 1 që thotë: Një organizatë buxhetore mundet pa marrjen e miratimit paraprak nga ministria të transferoj deri në 5 % të një ndarje buxhetore, në këtë rast nga kapitalet në një ndarje tjetër të asaj organizate buxhetore gjatë vitit fiskal, megjithatë këtë transfer nuk mundet ta bëjë në pagë. Pra përvèç kategorinë e pagave që e specifikon që nuk guxon të lëvizësh kategoritë tjera mundësh ti lëvizësh. Aq sa e kam shfletuar Ligjin për qeverisje lokale dhe Ligjin për menaxhimin e financave publike aty nuk specifikohet periudha se kur mundemi të bëjmë bartjen.

**Afrim Limani** – Kryetari komunës ka të drejtë të bëjë bartjen deri në 5 % pa miratimin nga ana e kuvendit, por ka të drejtë vetëm në atë kod, pra prej investimeve kapitale në investime kapitale ose nga mallrat dhe shërbimet në mallra dhe shërbime, e jo nga investimet kapitale në mallra dhe shërbime.

**Lulzim Sylejmani** – Është shumë e vërtet që ky 5 % i takon Kryetarit me vendos dhe me bartë, por kryetari ka kërkuar miratimin e Kuvendit që ti lejohet kjo bartje.

**Kryesuesi** - Mendoj se nëse e ndalon ligji atëherë as pagesat nuk do të mundë të bëhen dhe është e koton ne si kuvend të marrim vendim.

**Lulzim Sylejmani** - Ligji shumë mirë e specifikon, deri në 5 % mundet Kryetari komunës, deri në 15 % ministri, deri në 25 % Qeveria dhe prej 25 % e ka Kuvendi i Republikës së Kosovës, pra ndalohet vetëm lëvizja e pozicionit të pagave aty nuk guxojmë.

**Kryesuesi** – E qes në votim Vendimin për lejimin e bartjes së mjeteve nga një ndarje buxhetore në një ndarjetjetë. Konstatoj se me 2 kundra dhe 2 abstenime dhe të tjerët pro është aprovuar pika e 6 e rendit të ditës.

**7. Vendimi për pagesën e mëditjeve të komisioneve, një vendim të këtillë e kemi që e ka marrë kuvendi dhe është në fuqi. Ne duhet të kërkojmë që kuvendi të merë një vendim për kompozimin e të gjitha anëtarëve të komisioneve të caktuara të cilat i ka formuar kuvendi nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve.**

**Lulzim Sylejmani** – Mjete për pagesë në paga dhe mëditje nuk ka këtë ju kam treguar shumë herë, këtë vit çdo komunë ka probleme dhe mungesë të mjeteve në kategorinë e pagave. Kuvendi mund të merr një vendim por sa e di unë pagesat e komisioneve të bëhen nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve është shkelje. Unë do e ekzekutoj këtë vendim që do e merr kuvendi por duhet ta dini se është shkelje.

**Kryesuesi** – E qes në votim propozim Vendimin për pagesën e mëditjeve të komisioneve: Konstatoj se me 1 abstenim dhe të tjerat pro është aprovuar Vendimi që mëditjet e komisioneve të paguhen nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve.

#### **8. Pyetjet dhe përgjigjet në pyetjet e këshilltarëve.**

**Bahtjar Hoti** – Pjetje për Drejtoreshën e Arsimit: Disa konkurse që kanë qenë për shkollën e mesme, kriteret e konkursit kanë qenë të specifikuara, ku njëri prej kriterieve ka qenë të kenë përvjohje pune. Konkursi është kryer duke pranuar njerëz pa përvjohje pune dhe duke eliminuar njerëz që i kanë plotësuar kriteret. Personi i cili është pranuar dhe nuk i plotëson kriteret është Durim Ramadani nga Drenovci, ndërsa personi që është eliminuar është Igballe Hoti me Fakultet filologjik. Kërkoi një përgjigje dhe një sqarim nga drejtoresha e arsimit për këtë rast.

**Ejup Kabashi** – Pjetje për drejtorin e shërbimeve publike: rruga e segmentit Optersuhë – Retijë, kontrata është nënshkruar në vitin 2013 dhe tash ka skaduar. Premtimet e drejtorit kanë qenë se do të kryhet në vitin e kaluar. Dua ta pyes drejtorin se a e ka pa kontratën që i ka skaduar këtij pune kryesi, e di se mundet me një aneks të vazhdohet kontrata, dua një përgjigje dhe shuma e përgjithshme nga kjo kontratë që është 338,233.05 €, ndërsa shuma që ju është paguar këtij pune kryesi është 129,995.00 €, borxhe i ka komuna kësaj kompanie edhe 208,000.00 €.

**Selim Duraku** – Kam një pyetje rrreth asaj marrëveshje që ka lidhur komuna me kompaninë Radoniqi e cila me marrëveshje e ka të obliguar ti pastroj të gjitha kanalizimet në tërë komunën e Rahovecit. Janë bërë 4 muaj që paguajm tarifën prej 9 cent për m<sup>3</sup> ujë dhe përafërsisht familjet që janë rezidente në Rahovec, Radoniqi inkason afér 100,000.00 €. Kanalizimet dalin mbi asfalt sidomos në Fshatin Krushë e Madhe në 2 ose 3 vende ndërsa kompania e Radoniqit nuk bënë kurrrafë intervenimi. Dua ta di se sa intervenon komuna tek kompania e Radoniqit në këto raste.

**Kryesuesi** - Problemi me kanalizime kemi aty ku nuk ka kyçje ndërsa aty ku janë kanalizimet të kyçura në rrjet është në rregull, ndërsa ato kanalizime që janë të kyçura në rrjet dhe kanë kanalizime duhet të lajmërohet kompania e Radoniqit dhe ata vinë dhe e rregullojnë problemi.

**Arsim Kastrati** – Kam një pyetje për Drejtorin e Bujqësisë: në fshatin Drenovc para disa javë ka ra një rrebesh i breshërit dhe ka dëmtuar afér 77 hektarë vreshta. A është formuar ndonjë komision për të verifikuar dëmin e shkaktuar nga breshëri. Po ashtu kam një pyetje për drejtorin e shërbimeve publike, a është procesuar rruga e lagjes së Zatriqit.

**Azbi Gashi** – Kam një pyetje për ty kryesues, pse është duke u anashkaluar pika e rendit të ditës për Opsakos, kur e dimë se Ofakosi është hera e dytë që kërkohet të përfshihet si pikë të rendit të ditës, kur e dimë se kërkesa është e protokolluar.

**Afrim Limani** - Kam një pyetje për drejtorin e shërbimeve publike: në kuadër të projekteve kapitale është edhe projekti i ndërtimit të rrugëve në fshatrat e komunës së Rahovecit, në kuadër të këtij projekti fshati Dobidol, a është i përfshirë në prioritetet e juaja dhe nëse po a do të bëhet diçka në lidhje me realizimin e këtij projekti.

**Fatmir Iska** – Kam dy pyetje: e para është për drejtorin e ekonomisë, ne në muajin maj kemi mare një vendim si kuvend për lirimin e 50 % të pagesave nga ana e qiramarrësve të pronës komunale. Nëse ka mundësi drejtori të na informoj rrreth këtyre pagesave, sepse e kemi precizua në vendim se në afat prej 3 muajve kush nuk e kryen obligimin atëherë kthehem i në gjendjen e mëparshme. Pyetja e dytë është për drejtorin e shërbimeve publike, është fjala për kontratën intervenimet emergjente, nëse mundet të na informoj drejtori në seancën e radhës se ku janë bërë këto intervenime.

**Besnik Hoti** – Kam një pyetje për ju kryesues, në debatet publike që janë organizuar nga Kuvendi Komunal mendoj se ka qenë mirë që të jenë të informuar edhe kuvendarët, ne asnjëri nga kuvendarët e Ratkocit nuk kemi qenë të informuar se ka debat publik në fshatin Ratkoc.

**Rasim Fazliu** – Pyetja ime është rrreth shkollave të komunës së Rahovecit, gjendja nëpër disa shkolla të komunës sonë është jo e mirë sa i përket rregullimit të brendshëm, sepse vetë kam qenë prezent nëpër disa shkolla dhe i kam parë. Pyetja ime është a ka mundësi komuna që edhe këto pak shkolla që kanë mbetur në komunën tonë t'i riparojë.

**Kryesuesi** - Sa i përket pyetjes së Besnikut, njoftimi ka qenë në Ratkoc nëpër vende publike po ashtu njoftimi ka qenë edhe në web faqe të komunës 2 javë përpëra. Me ligje thuhet KPF organizon debate dhe anëtarët e KPF kanë qenë të informuar ndërsa të gjithë kuvendarët nuk e kemi për obligim ti njoftojmë.

**Fehim Fetoshi** – Fatmiri Pyeti për intervenimet emergjente, e kam bërë raportin janar - qershor për kryetarin e komunës i cili është edhe në web faqe të komunës dhe aty figurojnë të gjitha punët që janë kryer në kuadër të intervenimeve emergjente, janë 14 vende ku kemi intervenuar dhe intervenimi është bërë në ato vende ku ne i kemi

parë si ma të nevojshme por ka edhe shumë vende që kanë nevojë të intervenohet por kaq ka qenë mundësia e mjeteve në dispozicion. Arsimi pyeti për rrugën e Zatriqit, të enjten ose të premtena nuk jam sigurt është bërë shpallja e tenderit për rrugën e Zatriqit dhe shpresojmë se deri ka fundi i muajit shtator kryhen procedurat e tenderimit dhe në këtë vit të kryhet ajo rrugë sepse mjetet janë të zotuara nga MI. Afrimi pyeti në lidhje me kubëzimin e rrugëve në Dobidol. Në kuadër të projekteve të kubëzimit të rrugëve ka qenë politikë e Kryetarit të Komunës të cilën unë e kam zbatuar në përpikëri që të shpallen tender për kubëzimin e rrugëve nëpër lokalitete ku nuk ka pas kubëzim fare. Është kontrata për kubëzimin e rrugëve në Pastasel, Palluzhë, Dobidol, Kramovik, Guri i Kuq dhe Zoqisht, ndërsa konkretisht në Dobidol është e paraparë rruga tek shkolla.

Selimi pyeti për Radoniqin, ato amvisni të cilat nuk janë të kyçura në kanalizim kanë të drejtë të lirohen nga taksa e kanalizimit, por ata duhet të kenë gropën septike për kanalizim. Sa i përket mirëmbajtjes aty ku ka kanalizim është e vërtet se Radoniqi e ka për detyrë të bëjë mirëmbajtjen dhe pastrimin e kanalizimeve 2 herë në vit mirëpo duhet të jemi realist se kontratën e kemi bërë këtë vit në muajin maj dhe janë të fokusuar më tepër për pastrim aty ku ka më shumë nevojë, ndërsa për vitin 2016 do të kërkoj që ti përbahen kontratës. Ejup Kabashi pyeti për rrugën Opterushë – Retijë, jam shumë i vetëdijshëm për atë që flasë dhe premtimë nuk bëjë sepse premtimë bënë Kryetari i komunës unë jam vetëm këshilltar i Kryetarit, po ju ri konfirmojë se ndërtimi i rrugës Opterushë – Retijë kontrata është ashtu si e tha Ejupi, është kryer afér 85 % e punës në vitin 2013 dhe janë paguar vetëm 28,500.00 €, vitin e kaluar ne i kemi paguar për këtë projekt 140,000.00 € ndërsa këtë vit i kemi ndarë 80,000.00 €. Ne nuk mundemi me e detyruar operatorin të punoj sepse në ligje thuhet se pa zotimin e mjeteve operatorin nuk mundesh ta detyrosh të punon. Segmenti i rrugës Opterushë - Retijë operatori ka shpreh gatishmëri që ta kryej sivjet, ka premtimë nga ana e operatorit dhe jo nga unë që deri në fund të muajit shtator kjo punë do të kryhet.


**Ejup Kabashi** – E thash me plot arsyë se drejtori e ka dhënë fjalën publike që do të kryhet kjo rrugë, por nuk e ka mbajtur fjalën kjo rrugë ende nuk është kryer. Drejtori e tha se punët janë kryer 80 % nuk është e vërtet punët janë kryer diku afér 60%, janë arsyetuar se pusetat nuk i kanë mbuluar për arsy se do të vidhen dhe në 60 % të punimeve që janë vendosur pusetat dhe asnë puset deri më tanë nuk është vjedhur, pra ato janë vetëm gënjeshtra.

**Lulzim Hasku** – Po i përgjigjtem Arsimit në pyetjen që e parashtroj, ne fill pasi ka ra breshëri më 4 dhe 5 gusht e kemi formuar komisionin i cili ka dalë në vendin e ngjarjes dhe i kanë grumbulluar të gjitha të dhënat në një raport në lidhje me dëmet e shkaktuara nga breshëri, pjesët kadastrale që janë përfshiri janë: e Drenocit, Maqinës deri në fund të Nashpallës. Kemi dëmtime nga 5 % deri në shkatërrim total 95 % të vreshtave. Raportin e kemi dërguar në Ministrinë e Bujqësisë me një kërkesë që t'i ndihmohet fermerëve.

Mbledhja ka përfunduar në ora 14:25

Procesmbajtësi,  
Fahredin Sharku

Kryesuesi,  
Nahit Elshani



-III- Nr. I prot 4118 Më 31.08.2015  
Br. prot. DL RAHOVEC - ORAHOVAC